

# ANTIKOROZIN – BR

*Lyerje antikorozive me ngjyrë, për mbrojtje të sipërfaqeve të betonit të prodhuar në bazë të rrëshirave sintetike dhe tretësve*

*Përgjigjet në: EN 1504-2 (si lyerje mbrojtëse)*

## Fusha e aplikimit:

Për përpunim përfundimtar dhe dekorativ të sipërfaqeve të vjetra, të reja dhe të sipërfaqeve të riparuar të çimentos. Rekomandohet të konstruksionet e ekspozuara në ndikesa atmosferike, akull, kripëra si dhe në agresion të butë kimik: AB urra, murre mbajtëse, silose, objekte industriale, fabrika, tunele, objekte ankorimi dhe ngjashëm.

## Cilësi:

- Përzierje një-komponentëshe viskoze;
- Posedon adezion të shkëlqyer për nënshtresën;
- E pengon procesin e karbonizimit; Është i qëndrueshëm në akull, kripë, ujë të kripur dhe ndikesa të tjera atmosferike;
- Rezistent në naftë dhe derivate të naftës;
- Rezistent ndaj ujit;
- Jo-toksik (në gjendje të lidhur);
- Në dispozicion në më shumë ngjyra;
- UV stabil;
- Bakterologjikisht rezistent;
- Vendosje e thjeshtë;
- I lehtë për mirëmbajtje;

## Karakteristika teknike:

Cilësi	Vlerë e deklaruar
Dukje:	Përzierje pastoze me ngjyra
Përmbajtje e materieve të thata:	75±2%
Sasia e volumit:	1,55 g/cm <sup>3</sup>
Koha e tharjes:	70-80 мин
Adezioni për nënshtresën e betonit:	≥ 2,0 MPa

## Përgatitje e sipërfaqes:

Antikorozin-BR vendoset në nënshtresë të betonit ose suvasë së çimentos. Nënshtresa duhet të jetë e shëndoshë, e pastër, pa yndyrë dhe pa pluhur. Lagështia maksimalisht e lejuar e nënshtresës është 7,0 %, temperatura e nënshtresës duhet të jetë >5°C, ndërsa temperatura ambientale duhet të jetë në kufijtë prej 5°C deri 35°C.

Nënshtresa e betonit në të cilën vendoset Antikorozin BR duhet të ketë flejë minimum 14 ditë.

Nëse ka çarje, dëmtime ose pore në sipërfaqet e betonit, të njëjtat duhet të përpunohen me Reparatur suva F.

Për të fituar sipërfaqe të lëmuara në mënyrë ideale të njëjtat duhet të gletohen me Reparatur glet ose me Hidroglet-F, i cili duhet të vendoset që plotësisht të lidhet minimum 3 ditë në t=20°C para vendosjes së lyerjeve përfundimtare.

Nëse Antikorozin BR vendoset në sipërfaqe të betonit në të cilën paraprakisht ka paralyerje (të vjetra që ende janë aty), atëherë duhet të shihet puthitja e lyerjes ekzistuese dhe i njëjti duhet të ketë fortësi adezive ≥ 1,0 Mpa.

Nëse kjo nuk është kështu, lyerjet ekzistuese duhet të mënjanohet në mënyrë mekanike ose me fërkim me rërë, për të arritur nënshtresë e shëndoshë betoni e cila do të mundësojë arritje të lidhjes së fuqishme me lyerjet e reja të Antikorozin BR.

Gjatë 24 orëve të para pas vënies së lyerjes është tejet e nevojshme të mbrohet nga të reshurat, akullit, shkujës së fuqishme dhe pluhurit.

## Vendosje:

Vendosja bëhet me fuçë, cilindër në dy ose tre shtresa ose me makinë, me spërkatje deri në dukjen e dëshiruar. Materiali për shtresën e parë hollonhet me shtimin e 5-8% Rastvoruvaç-P dhe përzihet me mikser të ngadalshëm elektrik deri në homogjenizimin e plotë. Për vendosje të shtresave të ardhshme mund të hollonhet deri 5% me Rastvoruvaç-P. Distanca kohore midis vendosjes së shtresave është 4 orë në temperaturë prej 20°C. Çdo shtresë e ardhshme vendoset në drejtim normal (90°) në raport me shtresën paraprake. Gjatë vendosjes së Antikorozin BR, sipërfaqet e trajtuara duhet të jenë të mbrojtura nga të reshura dhe shkuja e fuqishme në periudhë prej 6 deri 12 orë.

### Vendosja makinerike:

- presion (150 – 200) bar;
- diznë (pipëz) 6.35; 7.45;
- këndi i spërkatjes: nën kënd të drejtë në raport me nënshtresën dhe në distancë prej (20 40) cm;

## Shpenzimi:

për dy shtresa	0,5-0,6 kg/m <sup>2</sup>
për tre shtresa	0,65-0,8 kg/m <sup>2</sup>

## Pastrimi:

Veglat dhe pajisja, menjëherë pas përdorimit pastrohen me RASTVORUVAÇ-P

## Paketimi:

Kanaçe teneqeje: 4 dhe 20 kg.

## Vendosja në depo:

Në ambalazh të mbyllur origjinal, në hapësira të thata, në temperaturë prej 5°C deri 35°C, i mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj diellit. Afati i përdorimit 9 muaj.

## Ngjyra standarde:

RAL 1015; RAL 7032; RAL 7046; RAL 7047; RAL 9002; RAL 9003

Vërejtje: Pjesa e RAL ngjyrave të tjera mund të prodhohen në rast të porosisë minimale prej 90 kg.

**Rezik për jetën:** Prodhimi përmban përbërës reaktiv të cilët në gjendje jo të lidhur ndikojnë në mënyrë të dëmshme mbi shëndetin. Gjatë përdorimit është e obligueshëm përdorimi i pajisjes mbrojtëse: doreza, maskë për sy. Të shmangët kontakti i prodhimit me lëkurën. Gjatë kontaktit incidental, prodhimi menjëherë të lahet me ujë dhe sapun. Nëse materiali stërpik sytë, nevojitet që menjëherë sytë të shpëlajen me shumë ujë si dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Nëse gëlltitet, nevojitet që menjëherë të kërkohet ndihmë mjekësore.

**Zjarr:** Antikorozin-BR dhe Rastvoruvaç – P përmbajnë materiale që mund të ndezën. Nuk duhet të jenë në afërsi të zjarrit të hapur ose të pihet duhan gjatë aplikimit.

**Pastrimi dhe vendosja në depo:** mbetjet e palidhura të Antikorozin-BR pastrohen me Rastvoruvaç – P. Ambalazhi i vjetër duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullativave lokale për atë lloj të mbetjeve.

Rekomandojmë që mënyra e aplikimit dhe sasi të nevojshme të përshtaten ndaj kushteve të objektit, si dhe përdorim i detyrueshëm i pajisjes përkatëse.